AGJENCIA
KOMBËTARE
E ZONAVE
TË MBROJTURA

EDUKIMI MJEDISOR

Nëntor 2023

Edukimi mjedisor natyror i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike mjedisore si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Edukimi mjedisor është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshin studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë veprimtarive, nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e shqetësimeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese etj., si dhe për mbrojtjen e dashurinë për natyrën.

"Natyra e di si t'i prodhojë efektet më të mëdha me mjetet më të kufizuara".

Heinrich Heine

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehi dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjëshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit

Përmes kësaj përmbledhjeje mujore Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, përgjatë muajit nëntor 2023, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin; atyre që ndodhen pranë ZM-ve, në zonat rurale.
Aktivitete janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **600**

Specialistë të angazhuar **11**

Orë mjedisore të realizuara **40**

39 Shkolla të përfshira

1 Universitete të përfshirë

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR

17 27 30

17 nëntor, me studentët e Universitetit “Luigj Gurakuqi”

Përgjatë një ore mjedisore, pranë Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", me studentë të degës Biologji-Kimi mundëm të ndanim prezantimin tonë “Zonat e Mbrojtura, oaz i Biodiversitetit në Shqipëri”.

27 nëntor, Java Europiane për Reduktimin e Mbetjeve

Realizuam një aktivitet sensibilizues pastrimi me nxënës të Shkollës së Mesme të Bashkuar "Lucë Agraja" në kuadër të "Javës Evropiane për Reduktimin e Mbetjeve" në oborrin e shkollës dhe mjediseve përreth.

Censusi i pelikanit kaçurrel

Së bashku me ekspertë ornitolog, natyralistët dhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Zogaj”, pjesë e Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës” zhvilluam Censusin Dimëror të Popullatës Perëndimore të Pelikanit kaçurrel (Pelecanus crispus) në Rezervatin Natyror të Menaxhuar "Liqeni i Shkodrës" dhe Peizazhin Ujor Tokësor të Mbrojtur "Lumi Buna - Velipojë".

30 nëntor, Java Europiane për Reduktimin e Mbetjeve

Organizuam një orë mjedisore me nxënës të shkollës 9-vjeçare "Hasan Dardhanjori" Ana e Malit, në kuadër të "Javës Europiane për Reduktimin e Mbetjeve".

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



08 14 02 06

8 nëntor, Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane

Stafi i AdZM Kukës zhvilloi një orë mjedisore me nxënës të shkollës së Mesme "Asim Vokshi" në Bajram Curr me temë: "Zhvillimi urban dhe zhvillimi i qendrueshëm i mjedisit".

14 nëntor, “Vlerat natyrore dhe monumentet e natyrës në PK “Korab-Koritnik”

Në kuadër të kësaj dite, zhvilluam një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Bajram Curri” Tropojë me temë “Rëndësia e Ekosistemeve. Nxënësit u njohën me rëndësinë e ekosistemeve në Parkun kombëtar Alpet Shqiptare. Përgjatë zhvillimit të orëve mjedisore, janë shpërndar fletëpalosje të përgatitura nga AdZM Kukës dhe AKZM.

2 nëntor, “Java Kombëtare e Ujit”

Me nxënës të shkollës 9-vjeçare “Dragobi”, Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore, në kuadër të Java Kombëtare e Ujit për Shqipërinë. Përmes saj synojmë të rrisim ndërgjegjësimin e nxënësve në organizim dhe në veprime konkrete sensibilizuese për Ujin, si një prej sektorëve më të rëndësishëm për zhvillimin e vendit.

6 nëntor, Promovimi i Monumenteve të Natyrës

Stafi i AdZM Kukës zhvilloi një orë mjedisore me nxënës të shkollës 9-vjeçare Krumë. Tema e përzgjedhur për t’u ndarë me nxënësit ishte promovimi dhe ruajtja e vlerave natyrore të zonës dhe të Monumenteve të Natyrës së Bashkisë Has, rëndësia e ruajtjes së tyre.

“EDUKIMI MJEDISOR” LEZHË

14 23

14 nëntor, Dita Botërore e Ruajtjes dhe Kursimit të energjisë

Specialistët e AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e Shkollës 9 - vjeçare "Adriatik" zhvilluan një orë mjedisore me temën "Çfarë dimë për energjinë", në kuadër të ditës botërore të Ruajtes/Kursimit të Energjisë. Më pas fëmijët punuan në mënyrë të pavarur dhe në fund duke ndarë mes tyre informacionet dhe prezantuar materialet e punuara nga vetë ata.

23 nëntor,

Java Evropiane për reduktimin e mbetjeve është një iniciativë që synon të promovojë zbatimin e veprimeve ndërgjegjësuese për burimet e qëndrueshme dhe menaxhimin e mbeturinave. Në kuadër të kësaj dite stafi AdZM Lezhe së bashku me nxënësit e Shkollës 9 - vjeçare “Kakarriq” zhvilluan një orë mjedisore me temë: "Konsumi dhe mbetjet''. Më pas fëmijët realizuan në grupe lojën ‘Zërat e pazakontë'' si dhe sollën disa shëmbuj sesi mund të riciklojmë sende të ndryshme.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR

08 23

8 nëntor, Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane

Në kuadër të kësaj dite, AdZM Dibër realizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Demir Gashi”. Nxënësit shprehën mendimet e tyre lidhur me zonat urbane dhe gjithashtu ndërtuan maketin e tyre të qytetit nën titullin “Qyteti ynë Ekologjik”.

23 nëntor, Java Evropiane e reduktimit të mbetjeve

Në kuadër të Javës Evropiane për Reduktimin e Mbetjeve, AdZM Dibër realizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Idriz Kaba". Me anë të koshave të improvizuar të riciklimit nxënësit patën mundësi të ndanin mbetjet e tyre në koshat e duhur dhe të mësonin më shumë rreth proçesit të riciklimit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS

08 14 23 01

8 nëntor, Dita e Zonave Urbane

Në Ditën Ndërkombëtare të Zonave Urbane, specialistë të AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Mustafa Myrteza Kaçaçi " në Krujë. Përmes maketit "Qyteti i blertë", nxënësit u njohën me avantazhet dhe disavantazhet e të jetuarit në një zonë urbane. Gjithashtu projekti ndikoi në këndvështrimet e nxënësve për të kuptuar se sa rëndësi ka që qytetet të kenë zona të gjelbëruara.

14 nëntor, Dita e kursimit të energjisë

Në kuadër të Ditës Botërore të kësaj dite, specialistë të AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare në Hamallaj, Durrës. Nxënësit u njohën me disa nga metodat alternative të kursimit të energjisë dhe ndikimin që ka konsumi i energjisë në mjedis.

23 nëntor, Java evropiane e zvogëlimit të mbetjeve

Në kuadër të Javës Evropiane për reduktimin e mbetjeve, specialistë të AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Zenel Qazim Tepshi" në Krujë me temë: "3 R e Mjedisit". Me anë të mbetjeve të ricikluesshme si: letra, kanaçet dhe shishet plastike nxënësit krijuan produkte të reja si: kuti për lapsat, flutura, breshka.

1 nëntor, Çelja e sezonit turistik dimëror

Me rastin e çeljes së sezonit turistik dimëror, specialistë të AdZM Durrës zhvilluan një orë mësimore me nxënësit e shkollës 9- vjeçare, në fshatin Cudhi Kampt e cila ndodhet brenda PN Qafështamë. Specialisët u treguan nxënësve për natyrën e mrekullueshme, që ofron parku në këtë sezon duke e kthyer atë në një nga destinacionet turistike më të njohura të vendit tonë. Gjithashtu nxënësit përmes vizatimeve dhe ngjyrave, njohën edhe më shumë disa nga llojet e faunës së parkut.

“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË

02 22 24

2 nëntor, Java Ndëkombëtarare e Ujit

Punonjësit e AdZM Tiranë realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës fillore "Brar", Njësisë Administrative Dajt. Nxënësit u njohën me rëndësinë e ujit, shkaktarët e ndotjes dhe problematikat që sjell ajo. Bashkë me ta ndoqëm edhe një video edukative, përmes së cilës treguam sesa e rëndësishme është ruajtja dhe menaxhimi i ujit për jetën në Tokë. Nëpërmjet një pyetësori nxënësit u zbavitën, duke përdorur dijet e përftuara nga prezantimi.

22 nëntor, “Flora në Parkun Kombëtar” Mali i Dajtit

Stafi i AdZM Tiranë së bashku me nxënësit e shkollës së Mesme të Bashkuar " Bahri Nela " në Zall-Bastar, realizuan një orë mjedisore me temë " Flora në Parkun Kombëtar" Mali i “Dajtit". Nxënësit u njohën me llojet e pyjeve halorë, fletorë; me llojshmërinë e bimëve mjekësore dhe rëndësinë e tyre.

24 nëntor, Mjedisi që na rrethon

Specialistët e AdZM Tiranë së bashku me fëmijët parashkollorë të shkollës fillore “Brar”, zhvilluan një orë edukative në lidhje me mjedisin që na rrethon.

“EDUKIMI MJEDISOR” NGA ADZM ELBASAN

06 08 01 03 13 14 15 20 23

6 nëntor, promovojmë vlerat natyrore

Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Isuf Gjura” Kuturman, pjesë e Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Kuturman” u realizua një aktivitet mjedisor pastrimi. Nxënësit së bashku me stafin e mësuesve të shkollës dhanë kontributin e tyre në pastrimin e territorit në brendësi të shkollës dhe zonës përreth saj. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve ne synojmë ndërgjegjësimin e nxënësve në mbajtjen pastër të mjedisit dhe zonave ku jetojmë, për të pasur një jetë sa më të shëndetshme.

8 nëntor, Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane

Në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare të Zonave Urbane " specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore bashkëvepruese me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Isak Alla" Zgosht, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Gjatë kësaj ore ata u njohën me rëndësinë që kanë hapësirat e gjelbërta në zonat urbane dhe se si ndikojnë ato ne cilësinë e ajrit. Gjithashtu ata realizuan edhe një mini-projekt me temë "Qyteti i gjelbërt", duke dhënë dhe mesazhe ndërgjegjësuese në mbajtjen e gjelbëruar të mjediseve ku ne jetojmë.

1 nëntor, Çelja e Sezonit Turistik Dimëror

Në kuadër të kësaj dite u zhvillua një aktivitet informues e argëtues me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shefqet Dosku” Dorëz, pjesë e “Parkut Kombëtar Shebenik". Gjatë nismës nxënësit realizuan një kënd të këndshëm me foto të disa prej atraksioneve turistike më të rëndësishme të parkut, duke dhënë dhe marrë mesazhe; duke ftuar të gjithë të apasionuarit pas turizmit malor.

3 nëntor, Ajër i pastër, jetë e shëndteshme

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një aktivitet mjedisor me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Rrahman Çota" Hotlisht, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Nxënësit u njohën me rëndësinë e kësaj dite; ajri i pastër dhe të jetuarit në mënyrë të shëndetshme. Për ta mundëm të improvizojmë procesin e pyllëzimit, duke folur për rëndësinë e tij.

13 nëntor, promovojmë vlerat natyrore

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan sot një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare "Asllan Shahini" Gramsh, në afërsi të Parkut Kombëtar "Mali i Tomorrit". Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe mjedisore të parkut, florën dhe faunën e tij. Gjithashtu ata u njohën edhe me monumentet e natyrës, të cilat ndodhen në territorin e Bashkisë Gramsh, që administrohen dhe menaxhohen nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Elbasan. Orët mjedisore kanë si qëllim përçimin e njohjes, promovimit të vlerave të bukurive natyrore dhe mbi të gjitha përçimin e dashurisë për natyrën tek brezat e rinj, një temë, me shumë interes për nxënësit.

14 nëntor, Dita Botërore e Ruajtjes/Kursimit të Energjisë

Në kuadër të kësaj dite, u realizua një orë mjedisore informuese me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Ahmet Elezi" Stravaj, në afërsi të Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Stravaj-Sopot". Gjatë kësaj ore nxënësit morën informacion rreth energjisë dhe mënyrën se si ta kursejmë atë, nëpërmjet paneleve diellore, përzgjedhjes së pajisjeve elektroshtëpiake etj. Në përfundim të materialit që u prezantua, nxënësit krijuan një kënd të vogël me disa nga pajisjet kryesore, duke theksuar mënyrën e përzgjedhjes së tyre, duke qenë sa më ekonomike.

15 nëntor, promovojmë vlerat natyrore

Në shkollën 9-vjeçare "Ali Hana" Rrajcë Skënderbe, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik", u realizua një orë e lirë mjedisore me nxënësit e kësaj shkolle, të cilët morën informacione të vlefshme dhe të reja rreth parkut, florës dhe faunës, si edhe një informacion më të detajuar rreth Monumenteve të natyrës që ndodhen në park. Gjatë kësaj ore nxënësit këmbyen mesazhe mbi rëndësinë e njohjes dhe promovimin e zonave të mbrojtura, në mënyrë që të kemi edhe një rritje të numrit të vizitorëve.

20 nëntor, aktivitet pastrimi

Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Ramazan Bala" Xibrakë, në afërsi të Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Qafë-Bush", u realizua një aktivitet pastrimit. Nxënësit së bashku me stafin e mësuesëve të shkollës dhanë kontributin e tyre në pastrimin e territorit në brendësi të shkollës dhe përreth saj. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve ne synojmë ndërgjegjesimin e nxënësve në mbajtjen pastër të mjediseve dhe zonave ku jetojmë, për të patur një jetë sa më të shëndetshme dhe dinjitoze.

23 nëntor, Java Europiane për Uljen e Mbetjeve

Në kuadër të "Javës Evropiane për Uljen e Mbetjeve", u realizuan aktivitete mjedisore dhe lojëra argëtuese, me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Librazhd Katund". Në bashkëpunim me organizatën EcoAlbania realizuam me nxënësit një aktivitet pastrimi në mjediset e shkollës dhe rreth saj, duke përçuar tek ta mesazhe ndërgjegjësuese për të mbajtur pastër mjediset ku jetojnë dhe rëndësinë e të jetuarit shëndetshëm. Gjithashtu, ata realizuan edhe disa lojëra shumë interesante me organizatën EcoAlbania, të cilat shpjeguan konceptin e "Korridorit Ekologjik", i cili kalon edhe në Parkun Kombëtar "Shebenik " si dhe rëndësinë e tij në vazhdimësinë e jetës së sigurtë të faunës së egër.

“EDUKIMI MJEDISOR”, ADZM FIER

27 30

27 nëntor, Java Evropiane për Reduktimin e Mbetjeve

Është një iniciativë që promovon zbatimin e veprimeve ndërgjegjësuese për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe mbetjeve gjatë një jave të vetme. Mbeturina është sasia e mbetur nga diçka (nga ndonjë gjësend) e që nuk ka ndonjë vlerë të caktuar. Ndotja përmes mbeturinave është një ndikim njerëzor në mjedis dhe mbetet një problem serioz mjedisor në shumë vende.

Në kuadër të Javës Evropiane për zvogëlimin e Mbetjeve, stafi i AdZM-së Fier së bashku me Grupin Junior Rangers zhvilluan aktivitet ndërgjegjësues. Fillimisht Grupi Junior Rangers u mblodh pranë zyrave dhe foli për Javën Evropiane për zvogëlimin e mbetjeve. Më pas u zhvillua një aktivitet ndërgjegjësues pastrimi i mbeturinave te Kanali i Vahut. Në Lagunën e Karavastasë e përfunduam aktivitetin tonë më vëzhgimin e zogjëve.

30 nëntor, Pelikani Xhon dhe historia e tij

Së bashku me nxënës nga Shkolla e Vlorës, zhvilluam një aktivitet mjedisor. Fillimisht nxënësit u njohën me vlerat e Parkut. Shumë të interesuar dhe kurioz ata njohën pelikanin Xhon dhe historinë e tij. Aktiviteti vazhdoi më tej me “birdwatching” në Godullë.

EDUKIMI MJEDISOR", ADZM BERAT

01 14 30

1 nëntor, Çelja e sezonit turistik dimëror

Në kuadër të kësaj dite, zhvilluam një orë mjedisore, pranë shkollës 9-vjeçare "Myslym Bakëri". Ndamë eksperiencat tona lidhur me frekuentimin e turizmit malor; përshkruajtëm ndjesitë përmes fotove nga pjesë të ndryshme, të vizituara gjatë stinës së dimrit, në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit".

14 nëntor, Ndotja nga plastika

U zhvillua një orë edukimi mjedisore, me nxënësit e shkollës "22 Tetori" Berat, për: Ndotjet nga plastika dhe problemet që shkakton ajo në shëndetin e njeriut.

30 nëntor, Java Evropiane për uljen e mbetjeve

Me rastin e kësaj jave zhvilluam një ore mjedisore, me nxënësit e shkollës "Zihni Toska". Ata sollën ilustrime dhe eksperienca nga praktika, të cilat secili prej nesh mund të përdorë për reduktimin e mbetjeve.

“EDUKIMI MJEDISOR”, ADZM KORÇË

07 20 21

7 nëntor, Ngjyrat e vjeshtës në PK Gërmenj

Grupi i Piktorëve nga qarku i Korçës, zgjodhi këtë herë Parkun Natyror të Gërmenjit, për të hedhur ne telaje ngjyrat e vjeshtës dhe peizazhin e mrekullushëm që kjo zonë ofron.

20 nëntor, Pelikani Kaçurrel dhe ai Rozë

Në bashkëpunim me organizatën PPNEA, u zhvillua një orë mjedisore në shkollën e mesme të Pustecit, për karakteristikat e Pelikanit Kaçurrel dhe Pelikanit Rozë. Pjesëmarrës në orën mjedisore ishte edhe ambasadori hollandez.

21 nëntor, njohim kafshët e zonës ku jetojmë

U zhvillua një orë mjedisore me fëmijët e klasës “Bambi”, të Kopshtit nr. 5 në qytetin e Korçës. Fëmijët u njohën me kafshët e rajonit ku ata jetojnë.

“EDUKIMI MJEDISOR”, ADZM GJIROKASTËR

01 08 10 23

1 nëntor, Çelja e sezonit turistik dimëror

AdZM Gjirokastër zhvilloi një orë mjedisore në shkollën pedagogjike “Pandeli Sotiri”. Me anë të imazheve dhe videove prezantuam pikat turistike si edhe vlerat e zonave të mbrojtura.

8 nëntor, Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane

AdZM Gjirokastër organizoi një orë mjedisore në shkollën 9-vjecare “Meleq Gosnishti” në Përmet. Nxënësit u njohën me ndikimin e mjedisit në zonat urbane.

10 nëntor, Njohim kafshët, banorët e ZM-ve

AdZM Gjirokastër ka realizuar një orë mjedisore me fëmijët e ciklit parashkollor Derviçan. Fëmijët u njohën me kafshët, banorë të zonave të mbrojtura, duke realizuar lojëra dhe vizatime të ndryshme. Së bashku duhet të kultivojmë dashurinë dhe respektin ndaj botës së egër si pjesë mjaft e rëndësishme e mjedisit tonë.

23 nëntor, Javën Evropiane për uljen e mbetjeve

Në kuadër të kësaj dite organizuam një orë mjedisore me temë “Konsumi dhe Mbetjet”.